



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 19 qershor 2014
Nr. ref.:RK643/14

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI104/13

Parashtrues

Adem Maloku

Vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Adem Maloku, i përfaqësuar nga z. Ali Latifi, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Aktvendimi i Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, ASC-11-0069, i 22 prillit 2013.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregullat 56 (1) dhe 74 (1) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Kërkesa ka për objekt çështjeje vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, ASC-11-0069, të 22 prillit 2013, përkitazi me të drejtën e supozuar të parashtruesit të kërkesës që të përfshihet në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI "Ramiz Sadiku" Prishtinë.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 korrik 2013, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 5 gusht 2013, Kryetari, me Vendimin Nr. GJR. KI104/13, caktoi gjyqtarin Kadri Kryeziu gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin Nr. KSH. KI104/13, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović (anëtarë).
7. Më 29 gusht 2013, parashtruesi u njoftua për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën ditë, kërkesa iu komunikua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Dhoma e Posaçme).
8. Më 26 shtator 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që të sqarojë disa aspekte të kërkesës së tij.
9. Më 13 shtator dhe më 3 tetor 2013, Gjykata kërkoi sqarim nga Dhoma e Posaçme për vendimet e Trupit gjykues dhe Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme përkitazi me kërkesën dhe pretendimet e parashtruesit.
10. Më 13 mars 2014, Kolegji shqyrtues, pas shqyrtimit të raportit paraprak, vlerësoi se raporti duhet të plotësohet akoma dhe shqyrtimin e shtyu për një datë tjetër.
11. Më 18 mars 2014, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të deklarohet përkitazi me sqarimet e Dhomës së Posaçme, të 3 shtatorit 2013, përkatësisht të 3 tetorit 2013.

12. Më 1 e 2 prill 2014, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Në një kohë të caktuar, parashtruesi ishte i punësuar si punëtor i NSH “Ramiz Sadiku”.
14. Më 27 qershor 2006, NSH “Ramiz Sadiku” ishte privatizuar.
15. Më 23 mars 2009, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një ankesë në Dhomën e Posaçme, kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP), me ç’rast kërkoi të përfshihej në listën e të punësuarve që gëzojnë të drejtën për një pjesë të të ardhurave nga privatizimi i NSH KNI “Ramiz Sadiku” në Prishtinë.
16. Më 10 qershor 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, me Aktgjykimin SCEL-09-0001, hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të papranueshme.
17. Me Aktgjykimin e lartpërmendur, SCEL-09-0001, të 10 qershorit 2011, Trupi gjykues i Dhomës së Posaçme, ndër të tjera kishte arsyetuar:

“... Trupi Gjykues vëren se në kohën privatizimit, ankuesi ishte mbi moshën 65 vjeçare, sipas dokumenteve në dosje (i lindur më 1 tetor 1939)...”.

“Trupi Gjykues konsideron se ankuesi nuk i plotëson kërkesat e Nenit 10.4 të Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut 2003/13 pasi që ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të NSH-së, 27 qershor 2006”.

18. Më 24 tetor 2011, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë te Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme, kundër aktgjykimit të Trupit gjykues.
19. Më 22 prill 2013, Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, me Aktvendimin ASC-11-0069, hodhi poshtë si të pabazë ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndër të tjera, duke arsyetuar:

“Trupi gjykues kishte gjetur se ankuesi i kishte plotësuar kriteret për të qenë në listën punëtorëve të cilët i gëzojnë të drejtat legjitime për 20 përqind të të ardhurave nga privatizimi i NSH-së, andaj ankesa është e papranueshme”.

20. Më 13 shtator 2013, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të sqarojë paqartësitë e lartpërmendura ndërmjet Aktgjykimit SCEL-09-0001 dhe Aktvendimit ASC-11-0069, të nxjerra nga Trupi gjykues përkatësisht nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme.
21. Më 20 shtator 2013, përkitazi me kërkesën e parashtruesit, Gjykata pranoi sqarim nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, ku, ndër të tjera, thuhej:

“Kolegji i Ankesave, pasi e ka shqyrtuar ankesën, ka vërejtur se z. Maloku (parashtruesi i kërkesës) ka bërë ankesë gabimisht, sepse ai ka qenë i

përfshirë në listë. Kolegji i Ankesave është dashur që të jap një zgjidhje për këtë ankesë, andaj për Kolegjin e Apelit ankesat e tilla janë të papranueshme, sepse i njëjti është i përfshirë në listën për të përfituar të drejtën e 20 për qind të të ardhurave nga shitja-privatizimi i ndërmarrjes dhe nuk është dashur që të parashtrroj ankesë”.

22. Më 3 tetor 2013, Gjykata kërkoi nga Dhoma e Posaçme që të dorëzojë dokumentacion relevant që përfundimisht do të sqaronte nëse parashtruesi i kërkesës ishte i përfshirë në listë të punëtorëve që gëzojnë të drejtën për përfitim nga një pjesë e të ardhurave të privatizimit të NSH "Ramiz Sadiku", ose jo.
23. Më 17 tetor 2013, Gjykata pranoi një sqarim tjetër nga Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme, ku, ndër të tjera, thuhej:

“Kolegji i Apelit me Aktvendimin ASC-11-0069 të datës 18 prill 2013, ankesën e ankuesit (ASC-11-0069-A0091), e ka hedhur poshtë si të papranueshme, duke menduar për z. Adem Maloku nga fshati Bradash... Këtu është bërë pshtjellim për shkak të emrave dhe mbiemrave të njëjtë, andaj është bërë edhe gabimi në procedurë. Është e qartë se z. Adem Malokut (parashtruesi i kërkesës) nga fshati Bellopojë e Podujevës me numër 619, në shkallë të parë iu kishte refuzuar ankesa si e pabazuar, dhe se Kolegji i Apelit, ankesën e ankuesit duhej ta përfshinte në Aktgjykimin ASC-11-0069 të datës 22 prill 2013 dhe të vendos në merita, duke e refuzuar si të pabazuar ankesën e tij.

Andaj, ju njoftojë se edhe po të ishte shqyrtuar ankesa e ankuesit Adem Maloku nga Bellopoja, ankesa e tij do të refuzohej si e pabazuar, sepse nuk i plotësonte kriteret e parapara në nenin 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13, pasi që ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të NSH-së”.

24. Më 20 mars 2014, përkitazi me shpjegimet e sipërpërmendura të Dhomës së Posaçme, parashtruesi i kërkesës, mes tjerash, komentoi: “... vet komentimet e kësaj gjykate, të posaqme [...], janë kontradiktore në mes vetit, këtë nuk po e them unë por ata vet po e dëshmojnë”.

Pretendimet e parashtruesit

25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se “... Aktvendimi ASC-11-0069, të dt. 18.04/13 Faqa nr. 4, arsytimi për Adem Malokun se ka të drejtë, por ka përjashtuar dëgjimin drejtpërdrejt që është shkelje e rëndë e procedurës”.
26. Parashtruesi po ashtu pretendon: “... vet Gjykata (Dhoma e Posaçme) ka konstatuar se me pa të drejtë është hjekë nga lista e 20%”.
27. Parashtruesi kërkon që të përfshihet në listën e punëtorëve që gëzojnë të drejta legjitime ndaj të ardhurave të grumbulluara nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku” dhe po ashtu pretendon se: “... njerëzit e pandërgjegjshëm më kanë larguar nga lista, këtë e vërteton edhe Gjykata Supreme e cila nuk më ka

udhëzuar se çka të bëj, nuk më janë dhënë këshilla juridike për ato që më takojnë”.

Dispozitat relevante

Ligji Nr. 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Neni 14

Shfuqizimi i ligjeve të mëparshme; konfliktet; interpretimi

4. Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.

LIGJI Nr. 03/L-006

PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 165

Korrigjimi i aktgjykimit

165.1 Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë.

Pranueshmëria e kërkesës

28. Për të qenë në gjendje për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullores të punës.

29. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

30. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 36 (1) c) të Rregullores së punës, që përcakton:

(1) “Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

(...)

c) kërkesa është qartazi e bazuar”.

31. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit për të gëzuar të drejtën e realizimit nga 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku”, Gjykata vëren se Trupi gjykues kishte hedhur poshtë ankesën e parashtruesit si të

papranueshme për shkak se ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të NSH “Ramiz Sadiku”, më 27 qershor 2006.

32. Gjykata, po ashtu, vëren se Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme është përgjigjur se parashtruesi nuk gëzon të drejtën e realizimit nga 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku” për shkak se ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.
33. Përkitazi me gabimet teknike ose ngatërrimet e identitetit, Gjykata konsideron se ato janë çështje të ligjshmërisë dhe se nuk është detyrë e saj që të përmirësojë gabimet e natyrës së tillë të gjykatave të rregullta.
34. Për më tepër, Gjykata vëren se kërkesa e parashtruesit në substancë nuk ka merita, sepse Trupi gjykues përkatësisht Kolegji i Apelit të Dhomës Posaçme kanë konstatuar se parashtruesi i kërkesës nuk gëzon të drejtën e realizimit nga 20% të të ardhurave nga privatizimi i NSH “Ramiz Sadiku” për shkak se ai kishte arritur moshën e pensionimit para datës së privatizimit të ndërmarrjes në fjalë.
35. Gjykata Kushtetuese rithekson se nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve dhe se vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta, ndërsa roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore. Prandaj Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (shih rastin *Akdivar kundër Turqisë*, Nr. 2189/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65 dhe, po ashtu, shih rastin KI86/11, parashtrues i kërkesës *Milaim Berisha*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 5 prillit 2012).
36. Përveç kësaj, kërkesa nuk arrin të dëshmojë që gjykatat e rregullta kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t’i vlerësojnë provat e vëna në dispozicion të tyre. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (shih rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
37. Fakti që parashtruesi nuk pajtohet me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
38. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

39. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe duhet të deklarohet e papranueshme në përputhje me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) c) të Rregullores së punës, më 1 dhe 2 prill 2014, njëzëri

VENDOS


- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues


Dr. sc. Kadri Kryeziu



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani